

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Nebojsa Boriqiç dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale të të dënuarit Rr. I. nga Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë P.nr.415/2015 datë 19.04.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë PAI.nr.915/2016 datë 23.08.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.11.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit Rr. I. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë P.nr.415/2015 datë 19.04.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë PAI.nr.915/2016 datë 23.08.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë P.nr.415/2015 datë 19.04.2016, i dënuari është shpallur fajtor i akuzuari Rr. I., për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili

dënim nuk do të ekzekutohet, po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk do të kryen ndonjë vepër të re penale.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, i dënuari është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo juridik.

Në procedurën ankimore, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren e sipas detyrës zyrtare është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë P.nr.415/2015 datë 19.04.2016, përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që dënimi i shqiptuar me kusht, duke vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit duke e detyruar që në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit ta liron banesën e cila gjindet në Suharekë në .....

Në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar sa i përket ankesës së Prokurorisë ngel i pa ndryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari Rr. I. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë të anulohet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.181/2016 datë 27.09.2016, me propozim që e njëjta të aprovohet.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

I dënuari në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 387 par.5 të KPK, për faktin se ka vendosur për lirin e banesës personit i cili paraqitet në cilësinë e të dëmtuarit pa e arsyetuar se ku mbështetet vendimi i marrur nga gjykata e shkallës së dytë, duke

konsideruar se e njëjta ka tejkalluar kufijtë e shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ana e përfaqësuesit të akuzës, i cili në ankesë ka kërkuar shqiptimin e një dënimi më të ashpër.

Pretendimet e të dënuarit të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara nga këto arsye:

Sipas aktvendimit të Kuvendit Komunal në Suharekë të datës 25.12.1991, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm , të dënuarit iu është urdhëruar që në afatin prej 10 ditësh ta bëjë lirin e banesës nga personat dhe sendet, e cila banesë gjindet në Lagjen “.....”. Nuk janë kontestuese se kjo banesë iu është dhënë në shfrytëzim S. S., ndërsa sipas kërkesës së tij Ministria e Financave në Beograd, resori për çështje pronësore , me aktvendimin e datës 10.06.1993, i lejohet blerja e banesës në fjalë ku sipas kontratës mbi shitblerjen të lidhur mes “...” nga Suhareka dhe blerësit S. S., banesa e cekur është tjetërsuar. Nuk janë kontestuese rrethanat se sipas autorizimit nga trashëgimlënësit të dëmtuarit R. B. iu janë dhënë çelësat e banesës nga Agjencia Kosovare e Pronës pas liritimit të banesës nga personat dhe sendet.

Po ashtu as i dënuari nuk i kontestohet rrethanat se i dëmtuari R. B. e ka blerë banesën kontestuese ndërsa i dënuari me forcë sërish ka hyrë në të njëjtën banesë.

Nga e gjithë kjo rrjedh se i dënuari akuzohet për veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.04.2016, vërtetohet se i dënuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës në pajtim me dispozitat ligjore për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti ka qenë i njoftuar për pasojat e pranimi të fajësisë se e ka kuptuar dhe i pranon pasojat e saj se pranimi i fajësisë është bërë me vetëdije të plotë dhe pa ndikim, me çka gjykata merr aktvendimin mbi pranimin e fajësisë.

Qëndron fakti se në ankesën të Prokurorisë Themelore e cila është paraqitur kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë ankesa është paraqitur vetëm për bazën ankimore të vendimit mbi dënimin duke kërkuar që të dënuarit t'i shqiptohet një dënim më i ashpër , e që sipas këtij propozimi gjykata e shkallës së dytë ashpërsimin e dënimit ka mund ta bëjë vetëm në kuadër të propozimit nga ankesa që do të thotë se ka mund ta ashpërsojë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar e që nga kjo rrjedh se gjykata e shkallës së dytë ka mund t'i shqiptojë dënim të kushtëzuar duke e kushtëzuar me lirin e pronës për një kohë të caktuar, mirëpo edhe përkundër

faktit se kjo nuk është vepruar është logjike që pasi vendimi të merr formën e prerë uzurpimi i banesës duhet liruar nga personat dhe sendet.

Pretendimet e te dënuarit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara për faktin se është e papranueshme që i njëjti të shpallet fajtor për uzurpim të banesës dhe sipas pretendimeve të tij sërish të qëndrojë në banesë.

Nga këto arsye kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

PML.nr.237/2016 datë14.11.2016

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa